



British Embassy
Tirana



**UK International
Development**

Partnership | Progress | Prosperity

MBI AKTET E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE LIDHUR ME PROCESIN ZGJEDHOR 2025

REPORT

ON THE ACTS OF THE INSTITUTIONS IN CHARGE OF THE ADMINISTRATION OF THE ELECTORAL PROCESS IN 2025

Gjetje nga monitorimi deri më 31.12.2024



Ky raport realizohet në kuadër të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” të mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë. Projekti zbatohet në një konkursium i drejtuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në partneritet me Institutin e Studimeve Politike (ISP), BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi vetëm e Institutit të Studimeve Politike (ISP) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të financuesve të tij apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

@Institutit i Studimeve Politike (ISP)

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

Facebook: Institutit i Studimeve Politike / Institute for Political Studies
Rezidenca "Garden Side", Rr " Faik Konica", Kati 1, Ap. 3, Tiranë

Hyrje

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 organizohen mbi bazën e Kodit Zgjedhor, i cili ndonëse u ndryshua në disa elementë dy herë gjatë vitit 2024 dhe 2025, në thelbin e tij ruan të njëjtin sistem administrimi të zgjedhjeve të vitit 2021.

- I. Element i ri është vetëm ai i votës së diasporës, për të cilin në këtë zgjedhje eksperimentohet për herë të parë, ndërkohë që legjislacioni rregullator nuk ka arritur të krijojë një bazë solide të njehsimit të standardeve të votimit brenda e jashtë vendit. Vota e diasporës *de facto* nuk monitorohet nga KQZ dhe instrumentet e tjera vendore të monitorimit, sidomos procesi i fushatës elektorale, financimi, përdorimi i burimeve shtetërore jashtë, etj. Procesi në diasporë më shumë bazohet në vullnetin politik të palëve për deklarim sesa në mekanizma parandalimi dhe verifikimi.
- II. Për shkak se shumica e rekomandimeve të ODIHR/OSBE 2021 dhe 2023 nuk janë miratuar në kuadër të komisionit të posaçëm të reformës zgjedhore në parlament dhe për shkak se fushatat po sjellin gjithnjë e më shumë elementë të rinj të paparashikuar nga legjislacioni i mëparshëm (rritja e peshës së mediave sociale, ndërhyrjet e jashtme në reklama, lobim dhe lajme, dezinformimi, përdorimi i formave të reja të komunikimit si postcards, etj.) monitorimi dhe standardet zgjedhore përballen me sfida të reja dhe vështirësi gjatë gjithë fazës përgatitore të zgjedhjeve 2025.

Në kuadër të përgjithshëm analiza e mjedisit aktual parazgjedhor merr në konsideratë rolin e institucioneve të ngarkuara nga ligji për përgatitjen dhe administrimin zgjedhor, për sigurimin e dispozitave kundër krimit zgjedhor dhe për jetësimin e integritetit të procesit. Në këtë fazë partitë politike, koalicionet dhe vetë kandidatët janë ende aktorë jo përcaktues, për shkak se vetëm në mesin e muajit mars subjektet dhe kandidatët regjistrohen duke nisur edhe *de facto* fushatën elektorale.

Instituti i Studimeve Politike (ISP), në partneritet me Komiteti shqiptar i Helsinkit (KSHH), BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ), me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike po zbaton projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike 2024-2025”. Në kuadër të realizimit të objektivave të projektit, ISP ka realizuar monitorim të vazhdueshëm për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe nxjerrjen e akteve nënligjore nga organet e pavarura dhe qeveritare, për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin në 11 maj 2025.

I. ROLI I INSTITUCIONEVE QENDRORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 1 të saj sanksion si një nga parimet themelore se Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike. Rregullat për zhvillimin e zgjedhjeve parashikohen në ligj.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, ka përcaktuar rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet.

Legjislacioni¹ që rregullon organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri pas vitit 1990, ka pësuar ndryshime dhe rishikime të shumta, duke reflektuar rritjen e standardeve demokratike që ka pësuar Shqipëria në këto 34 vite. Ndryshimet e pas vitit 2009 e në vijim në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin “Për partitë politike” me ndërhyrjen e fortë të faktorit ndërkombëtar, kanë parashikuar rregulla sjelljeje për periudhën që nga dalja e dekretit të Presidentit për datën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe krijimin e qeverisjes së re, qendrore apo lokale, duke përfshirë jo vetëm administratën zgjedhore, por edhe institucionet publike, agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, me qëllim mos-ndërhyrjen në procesin zgjedhor të qeverisjes qendrore, lokale dhe agjencie qeveritare gjatë procesit zgjedhor.

Kodi Zgjedhor ka sanksionuar në mënyrë të qartë ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, duke përcaktuar kuptimin sipas ligjit, të termit “burime” dhe “burime njerëzore”. Megjithatë, ndryshimet e fundit të cilat parashikuan për herë të parë pjesëmarrjen në votime nga vendi ku jetojnë, për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, është akoma një sfidë e cila nuk është zbatuar asnjëherë. Zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 maj 2024 janë testi që do të vërtetojë suksesin ose jo të këtij procesi, i cili prej vitesh funksionon të paktën në disa vende të rajonit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kryesisht në katër zgjedhjet e fundit ka nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar veprimtarinë jo vetëm të administratës zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, por dhe të institucioneve të tjera të qeverisjes qendrore dhe lokale, policisë së shtetit, si dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të garantuar mbështetje nga këto institucione për organizimin e zgjedhjeve apo dhe për ndjekjen penale për vepra penale në fushën e zgjedhjeve të denoncuar gjatë periudhës zgjedhore. Gatishmëria për të mbështetur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga Qeverisja Qendrore, por dhe lokale me logjistikën e nevojshme nuk ka munguar, gjë e cila nuk mund ta themi se ka qenë për ndjekjen e veprave penale dhe denoncimet për shkelje të ligjit si, shitblerja e votës, prishja e rendit dhe qetësisë në ambiente zgjedhore, etj.

Megjithatë në vitet e fundit, ndërgjegjësimi ka qenë dhe nga institucione të tjera përveç Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të nxjerrë akteve nënligjore për të rregulluar veprimtarinë dhe sjelljen

¹ Kodi Zgjedhor, Ligji për Partitë Politike, Ligji 138/2015 për Dekriminalizimin etj.

e institucioneve të Qeverisjes Qendrore, Administratës publike, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nga këto Institucione. Në çdo rast sfidë ka qenë zbatimi i tyre.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri në zgjedhjet e vitit 2019, gjatë periudhës zgjedhore rregullisht nënshkruanin memorandume bashkëpunimi për të vendosur disa ura bashkëpunimi përveç detyrimeve Kushtetuese dhe Ligjore për të dyja palët.

Me qëllim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidatëve për t'u zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efikasitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose veprave penale të tjera, që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë në zgjedhjet e vitit 2019, Prokurori i Përgjithshëm, miratoi Udhëzimin e Përgjithshëm, nr. 03, datë 21.06.2019, *“Mbi masat administrative dhe procedurale në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”*.

Në zgjedhjet e vitit 2021, Prokurori i Përgjithshëm, me udhëzimin e përgjithshëm nr. 02, datë 31.03.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 03, datë 21.06.2019, *“Mbi masat administrative dhe procedurale në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”*, jo vetëm rikonfirmoi masat e miratuara, por rregulloi në mënyrë më specifike dhe konkrete informacionin me të dhëna/tregues për procedime/çështje penale, nga Prokuroria e Përgjithshme në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në çdo rast duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit.

Me udhëzim nr. 04, datë 18.02.2025 Prokurori i Përgjithshëm shpalli *“Masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”*². Sipas udhëzimit, Prokuroria krijon struktura monitoruese dhe vlerësuese të rasteve të krimeve zgjedhore si dhe përcaktohet procedura e bashkëpunimit dhe komunikimit me SPAK, KQZ, Policia e Shtetit, etj. Drejtuesit në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, detyrohen të krijojnë seksionin e posaçëm kundër krimit zgjedhor i cili do të funksionojë deri në datë 31.05.2025 dhe do të ketë në përbërje prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë dhe oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë së Shtetit.

Sipas udhëzimit, Prokurori për marrëdhëniet me publikun, nën mbikëqyrjen e drejtuesit të prokurorisë, përpilon raportin 24 orësh për veprimtarinë e të gjithë prokurorëve për veprat penale

² Prokuroria e Përgjithshme, https://www.pp.gov.al/rc/doc/Udhezim_2_2025_per_zgjedhjet_7663.pdf

që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për çdo vepër penale tjetër që dëmton procesin zgjedhor.

Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm përcakton edhe detyrimet lidhur me dekriminalizimin, sipas të cilave, sektori i Dekriminalizimit trajton me prioritet kërkesat e KQZ-se për verifikimin e integritetit të personave kandidatë për t'u zgjedhur, kërkesa të shoqëruara me formularët e vetëdeklarimit dhe relacionin/dokumentacionin përkatës, për verifikimin e thelluar në zbatim të ligjit nr.138/2015 për të shmangur zgjedhjen e atyre kandidatëve që ju ndalohej të ushtrojnë funksione publike.

Prokurori i Përgjithshëm cakton se për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive dhe prokurori e personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët për ecurinë e zbatimit të tij informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm dhe ky i fundit, më pas edhe publikun.

Referuar akteve nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ketë Informacion dhe statistika me të dhëna/tregues për procedime/çështje penale të regjistruara, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, numrin e personave nën hetim ose të pandehurve, vendimet përfundimtare dhe numrin e dënimeve nëse ka etj.

1. Kritikata e mëparshme (zgjedhjet e kaluara) kanë janë të tilla që nga Prokuroria e Përgjithshme ka munguar një analizë në lidhje me funksionalitetin dhe efektshmërinë e rregullave të miratuara apo dhe analizë e thelluar për nevoja me rishikim ose jo të këtyre akteve në të ardhmen, në kuadrin ligjor të prokurorisë apo atë të partive politike ose të Kodit Zgjedhor.
1. Gjithashtu kritikata kanë cituar edhe faktin se në të kaluarën rastet e denoncimeve të hetuara dhe të përballjes së personave përgjegjës përpara drejtësisë kanë qenë minimale, ka pasur standarde të ndryshme për të njëjtat raste, ka pasur pretendime për konflikt interesi dhe se në tërësi proceset kanë marrë kohë, janë zhvilluar *post factum*, duke ndikuar në rënien e besimit publik të dhënia e drejtësisë zgjedhore.

QEVERIA SHQIPTARE DHE ROLI I SAJ NË PROCES

Qeveria Shqiptare më datë 20 prill 2023, miratoi Vendimin nr. 234, datë 20.04.2023, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave (më poshtë VKM) nr. 234, datë 20.04.2023, ka për qëllim marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike

në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektorale, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

Sipas VKM 234/2023, monitorimi dhe rregullat specifike të sjelljes për këtë pjesë të mbetur të fushatës përfshijnë një numër të lartë të punonjësve të administratës publike si:

- Punonjësit e administratës shtetërore, sipas nenit 4, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe punonjësit e tjerë civilë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;
- Punonjësit e Policisë së Shtetit;
- Punonjësit e Gardës së Republikës;
- Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit;
- Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura;
- Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë.

VKM 234, ka për qëllim të sqarojë pozitën dhe të përcaktojë të drejtat, detyrimet dhe ndalesat e subjekteve të përmendura më sipër, gjatë kësaj periudhe të mbetur të fushatës, në orarin zyrtar të punës dhe jashtë këtij orari. Gjithashtu, akti parashikon ngritjen dhe funksionimin e Task-Forcës për koordinimin e procesit të monitorimit i cili drejtohet nga Zëvendëskryeministri.

Roli i Task-Forcës ngelet kryesisht në kuadër të një strukture e cila do të mbledhë informacion, do të denoncojë sipas rastit për shkelje të mundshme të rregullave gjatë periudhës zgjedhore në organin e akuzës në Prokurori, apo në Policinë e Shtetit. Përveç raportimin dhe monitorimit nga Organizatat e Shoqërisë Civile apo vëzhguesit ndërkombëtarë, nuk ka analiza për efektshmërinë apo funksionalitetin në luftën kundër korrupsionit në Zgjedhje nga kjo strukturë e posaçme.

Gjatë vitit 2025 ende qeveria nuk ka bërë të ditur nëse do të ketë Task-Forcë dhe nëse vetë qeveria do të aplikojë mekanizma parandalimi të shkeljes së Kodit Zgjedhor për strukturën e saj ekzekutive. Qeveria gjithashtu nuk ka shpallur ende masa kufizuese për burimet shtetërore (përdorimi i mjeteve zyrtare, kalendari i aktiviteteve, evitimi i masave ligjore apo administrative me efekt elektorale, shmangia e përfshirjes së administratës në zgjedhjet, etj.).

Ndonëse përvoja e kaluar ka qenë kryesisht me rezultate modeste dhe deklarative, një akt i tillë do të ishte tregues se qeveria i bashkohet apelit dhe nevojës për monitorim të thelluar të keqpërdorimit të burimeve shtetërore.

Nga ana tjetër vlen të theksohet se të gjithë ministrat, përfshirë edhe ministrat e rinj të brendshëm dhe të financave, të cilët nuk rezultojnë se kanë pasur aktivitete politike në të kaluarën, janë përfshirë intensivisht në fushatë elektorale dhe janë drejtues të zonave të caktuara zgjedhore, pjesë e fushatës së PS.

PROKURORIA E POSAÇME (SPAK)

Për herë të parë në këtë proces zgjedhor kemi një institucion të ri aktiv kundër krimit zgjedhor, SPAK. Përfshirja e SPAK duket se dublon Prokurorinë e Përgjithshme gjithsesi objekti i aktivitetit të tij përfshin krime dhe kategori shumë më specifike, ndaj edhe përfshirja ka qenë dhe mbetet e mirëpritur.

SPAK ka bërë *headline* gjatë vitit 2024 dhe 2025 me masa aktive kundër personave me pozita të larta drejtuese në shtet dhe parti politike, të akuzuar për krime të ndryshme penale, përfshirë edhe korrupsion zgjedhor. Një deputet i mazhorancës është tashmë në arrest me burg i akuzuar direkt për krime zgjedhore më 2021, si dhe për lidhje e bashkëveprim me grupet kriminale. Ndonëse zbulimi dhe masa ndaj tij erdhi në vitin e fundit të mandatit gjatë legjislaturës, pra pas konsumimit prej tij të disa viteve deputet, zhvillimi shënoi një fazë të re dhe fokus të ri për SPAK. Paralelisht SPAK ka iniciuar hetime dhe masa ndaj disa kryebashkiakëve dhe zyrtarëve të tjerë lidhur me krime të ndryshme zgjedhore.

SPAK publikoi në janar 2025 strategjinë e tij për masat lidhur me procesin zgjedhor³. Sipas dokumentit tashmë publik, objektivat e strategjisë janë:

1. Identifikimi sa më i shpejtë i indiceve mbi mundësitë e kryerjes së veprave penale dhe shkeljeve ligjore në kuadër të zgjedhjeve që mund të ndikojnë në integritetin e procesit zgjedhor.
2. Identifikimi dhe parandalimi i ndikimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit të funksionarëve shtetërorë dhe subjekteve private në procesin zgjedhor për të siguruar një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhor për Kuvendin 2025.
3. Përmirësimi i kapaciteteve hetimore të Prokurorisë së Posaçme për të hetuar dhe ndjekur rastet e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve në mënyrë efektive.
4. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut mbi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet hetimore dhe rolin e tyre ndërveprues në parandalimin e krimit zgjedhor.
5. Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet publike, shoqërinë civile, median dhe çdo subjekt privat për të parandaluar veprat penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025.
6. Parandalimi i ndikimit të jashtëm dhe manipulimit të procesit zgjedhor përmes monitorimit në kohë reale dhe ndërhyrjes së shpejtë në rastet e dyshimta të shkeljes së ligjit.
7. Kryerja e hetimeve profesionale dhe të shpejta për subjektet që kryejnë shkelje zgjedhore, duke dërguar një mesazh të qartë se krimi zgjedhor do të ndiqet dhe ndëshkohet.

³ SAPK. <https://spak.gov.al/ep-content/uploads/2025/02/Strategjia-e-Hetimit-dhe-Parandalimit-te-Krimit-Zgjedhor-per-Zgjedhjet-per-Kuvendin-2025.pdf?>

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL PP-KQZ-SPAK

Në funksion të koordinimit institucional, SPAK, KQZ dhe Prokurori i Përgjithshëm hartuan dhe publikuan një memorandum bashkëpunimi⁴. Sipas njoftimit zyrtar protokoli i bashkëpunimit midis tri institucioneve do të vijojë gjatë gjithë periudhës zgjedhore, me koordinim të vazhdueshëm mes institucioneve, për të siguruar një proces të lirë, të drejtë dhe të ndershëm, dhe në thelb, ai synon:

- a) garantimin e integritetit të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025 dhe parashikon masa të koordinuara për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e veprave penale që lidhen me zgjedhjet;
- b) forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve për të siguruar një shkëmbim të shpejtë dhe efikas të informacionit mes institucioneve përgjegjëse për ndjekjen e veprave penale zgjedhore;
- c) koordinimin efektiv të veprimeve hetimore, duke krijuar mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin dhe ndjekjen ligjore të çdo rasti që cenon procesin zgjedhor;
- d) angazhimin të punojnë në mënyrë të vazhdueshme për forcimin e sistemit të drejtësisë zgjedhore, duke siguruar një proces elektoral të drejtë dhe të pandikuar nga elementë të jashtëm;
- e) rritja e transparencës, forcimi i besimit publik tek procesi zgjedhor dhe krijimi i një mjedisi ku shkeljet zgjedhore parandalohen dhe ndëshkohen në mënyrë efektive.

II. KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Komisioneri për Mbikëqyrjen e shërbimit civil, nisur nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2017, ka miratuar rregullisht përpara periudhës zgjedhore për zgjedhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe, urdhra dhe udhëzues për unifikimin, monitorimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me "*Platformat*" apo "*Rrjetet sociale*", që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale, si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, ka miratuar Urdhrin nr.15, datë 03.02.2023, "*Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor*" dhe udhëzimin nr. 11, datë 10.02.2023 "*Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të*

⁴ KQZ. <https://kqz.gov.al/2025/02/27/firmoset-protokoli-i-koordinimit-per-integritetin-e-zgjedhjeve-per-kuvendin-2025/>

tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me "Platformat" apo "Rrjetet sociale", që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën."

Komisioneri, pas analizës për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të miratuara prej këtij Institucioni, duhet të rishikojë aktet nënligjore përpara zgjedhjeve të datës 11 Maj 2025.

Referuar nenit 91 e në vijim të Kodit Zgjedhor, Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut rreth tyre, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Sjellja në përputhje me ligjin e institucioneve publike, përfshin dhe veprimtarinë e burimeve njerëzore në këto institucione. Në këto kushte, rishikimi apo miratimi i akteve të reja dhe njoftimi i institucioneve publike për zbatimin e tyre duhet të bëhet menjëherë nga Komisioneri.

III. AKTET NËNLIJORE TË KQZ PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE 2025

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

Organet drejtuese të KQZ-së janë:

- a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- b) Komisioni Rregullator;
- c) Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.

Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.

AKTET NËNLIGJORE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj” e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar duhet të nxjerrë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit që do të thotë jo më vonë se muaji dhjetor 2024.

Deri më dhjetor 2024, rreth 5 muaj para zgjedhjeve, janë miratuar 230 akte nga të cilat 14 akte janë akte që përcaktojnë rregulla për organizmin e zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin.

Akte nënligjore të miratuara nga Rregullatori

Nga shqyrtimi faqes zyrtare të web-it të KQZ-së⁵, Rregullatori sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 20 të Kodit Zgjedhor, ka miratuar 4⁶ vendime për miratimin e rregullave për një nga proceset zgjedhore më të rëndësishme, që do të zbatohen për herë të parë në historikun e zgjedhjeve pluraliste në Shqipëri, për procedurën e votimit nga jashtë vendit.

Aktet normative për këtë qëllim kanë rregulluar jo vetëm mënyrën dhe procedurën e votimit të shtetasve shqiptarë, që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, por gjithashtu kanë përcaktuar dhe karakteristikat e specifikimet e pajisjeve të logjistikës, sistemet dhe platformat elektronike që mund të përdoren, dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar, që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rregullat për regjistrimin e këtyre zgjedhësve dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve .

Gjithashtu, Rregullatori ka miratuar caktimin e kufijve dhe ngritjen e 93 (nëntëdhjetë e tre) Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025. Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një ZAZ, duke respektuar kriterin e pandashmërisë së territorit të njësisë administrative, vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit, barrierat gjeografike, mundësitë e mira të komunikimit brenda territorit dhe numër të përafërt zgjedhësish.

Nga shqyrtimi i akteve të miratuara nga Rregullatori, rezulton se KQZ nuk ka nxjerrë akte normative, apo nuk ka rishikuar aktet e miratuara në lidhje me:

- vendosjen e rregullave për subjektet zgjedhore;
- financimin e fushatës zgjedhore;
- monitorimin e medias gjatë fushatës zgjedhore;
- implementimin e sistemeve elektronike për numërimin dhe identifikimin elektronik të zgjedhësve;
- organizimin dhe funksionimin e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë respektivisht KZAZ dhe KQV, që janë kompetencë e Rregullatorit;

⁵ Referuar Kodit Zgjedhor, KQZ ka detyrimin e publikimit të akteve të miratuara në faqen zyrtare të Internetit

⁶ sipas akteve në tabelën bashkëlidhur

- metodologjinë e kontrollit financiar të partive politike në zgjedhje, rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, detyrime të përcaktuara në nenin 20, pika 1, germa f, dhe ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”;
- monitorimin e medias, parashikuar nga neni 20, pika 1, germa ç.

Akte nënligjore të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Deri në periudhën e hartimit të këtij raporti, Komisioneri ka miratuar gjithsej 192 vendime, 4 prej të cilave janë akte për zhvillimin e zgjedhjeve të vitit 2025. Aktet e Komisionerit, referuar kompetencave të përcaktuara në nenin 19 të Kodit Zgjedhor duhet të rregullojnë marrëdhënie me objekt (sipas akteve në tabelën bashkëlidhur):

- menaxhimi financiar (hartimi i projektbuxhetit të KQZ-së, për organizimin e zgjedhjeve, për vitin kalendarik, caktimi i sasisë së fondeve nga buxheti i shtetit për partitë politike);
- regjistrimi i subjekteve zgjedhore;
- emërimi i komisionerëve të KZAZ-ve;
- miratimi i modeleve dhe specifikimeve teknike të materialeve zgjedhore;
- verifikimi i formularëve të dekriminalizimit;
- shqyrtimi i ankesave dhe denoncimeve në lidhje me përdorimin e burimeve shtetërore nga subjektet zgjedhore.

Komisioneri ka miratuar gjithsej 4 vendime⁷ duke rregulluar disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor (teknike dhe procedurale), kryesisht për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, si: miratimi i dokumentit strategjik dhe operacional për trajnimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë, për proceset zgjedhore, për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe standardizimin e trajnimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të institucioneve homologe, rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet “PER”-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, programet e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nga jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.

Ky është një program i detajuar për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe synon të sigurojë pjesëmarrjen aktive të diasporës në procesin zgjedhor, duke ofruar udhëzime dhe informacione të nevojshme për ushtrimin e së drejtës së votës.

Komponentët kryesorë të programit përfshijnë:

1. Informimi mbi mundësinë e votimit nga jashtë vendit;
2. Udhëzime për regjistrimin në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER);
3. Verifikimi i emrit në listën e zgjedhësve;

⁷ sipas akteve në tabelën bashkëlidhur

4. Udhëzime për plotësimin dhe dërgimin e fletës së votimit;
5. Transparenca në administrimin dhe numërimin e votave.

Procesi i votimit të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duket të jetë *“thembra e Akilit”* në zgjedhjet e ardhshme. Numri i shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë është relativisht i madh dhe mund të prodhojë disa mandate. Suksesi i arritjes së pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025, të shqiptarëve që jetojnë jashtë, varet pikërisht nga përcaktimi i qartë i rregullave për regjistrimin e tyre, procesi i votimit në vetvete, fushata e informimit dhe edukimit të tyre për zbatimin e procedurave dhe sigurisht garantimi i logjistikës së nevojshme për këtë qëllim.

Koha prej rreth 4 muaj e gjysmë përpara zgjedhjeve mund të jetë e ngushtë për garantimin e suksesit të së drejtës së votës së zgjedhësve shqiptarë, që jetojnë jashtë vendit, megjithatë monitorimi në vijimësi i këtij procesi do të japë dhe të dhëna më të sakta.

Referuar Nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, KQZ, jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera sipas këtij Kodi, nga subjektet zgjedhore.

Aktualisht më datë 06.12.2024, rreth një muaj me vonesë, KQZ ka miratuar caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të tyre nuk ka filluar ende.

REPORT

ON THE ACTS OF THE INSTITUTIONS IN CHARGE OF THE ADMINISTRATION OF THE ELECTORAL PROCESS IN 2025

Introduction

Albania's 2025 parliamentary election is organized on the basis of the current iteration of its Electoral Code, which, although partially amended in 2024 and 2025, maintains, in essence, the same electoral administration system first established to administer the 2021 election.

The only new element for the 2025 election concerns out of country voting, commonly known in Albania as the "diaspora vote", which is being experimented with for the first time in this electoral cycle. The legislation adopted to this end has failed to create a solid basis for unifying voting standards inside and outside the country. The "diaspora vote" is de facto not monitored by the CEC and other local monitoring entities, especially as concerns the conduct of the electoral campaign process, campaign financing, use of state resources abroad, and so on. Public disclosure on the electoral process in the diaspora is based more on the political will of the parties than on actual prevention and verification mechanisms.

Since most of the ODIHR/OSCE 2021 and 2023 recommendations have not been adopted by the special commission on electoral reform in the parliament and taking into account the fact that electoral campaigns are increasingly bringing in new elements unforeseen by the existing legislation (increased weight of social media, external interference in advertising, lobbying and news, disinformation, use of new forms of communication such as postcards, etc.), we can safely conclude that Albania's electoral standards in general and electoral monitoring in particular are bound to face new challenges and difficulties throughout the preparatory phase of the 2025 election.

Under the present framework, the analysis of the current pre-election environment takes into account the role of the institutions tasked by law to provide for the integrity of the electoral administration, e.g., to engage in fighting electoral crime and in ensuring the proper conduct of the electoral process in its entirety. At this stage, political parties, coalitions and candidates themselves are still legally non-determining actors, because subjects and candidates register only in mid-March, and that starts, at least de jure, the electoral campaign.

From December 2024 to February 2025, the Institute of Political Studies (ISP), in partnership with BIRN Albania and Qëndresa Qyvetare, and with the financial support of the British Embassy, has implemented the project "Strengthening the integrity of elections and the sustainability of political parties 2024-2025". The project aims to monitor the implementation of legal obligations, the issuance of by-laws by independent and government bodies, for the organization of general election for the Assembly on May 11, 2025.

This report concerns the monitoring of the acts issued for this purpose until December 31, 2024.

I. ROLE OF CENTRAL INSTITUTIONS

Since its first iteration back in 1990, the law⁸ regulating elections in Albania has been subject to frequent changes and amendments, aimed at capturing the improvement of Albania's democratic standards over the last 33 years. Several partial changes have been made to the law over the last couple of years, but these have not amounted to a substantial electoral reform.

The Electoral Code explicitly sanctions the prohibition of using public resources to support electoral subjects, defining the legal meaning of the term's "resources" and "human resources." However, the recent amendments, which for the first time provided for the electoral participation of Albanian citizens living abroad from their place of residence, remain a challenge that has yet to be implemented.

The Central Election Commission (CEC), particularly over the last four elections, has issued sub-legal acts to regulate, in addition to the activities of the electoral administration and electoral subjects, also those of other central and local government institutions, and of the State Police, and has signed cooperation agreements to ensure proper support from these institutions for the organization of elections or for the criminal prosecution of electoral offenses reported during the election period. The readiness of central and local government to support the CEC with the necessary logistics has not been lacking, though the same cannot be said for the prosecution of criminal offenses and reports of legal violations, such as vote buying, disruption of order and peace in electoral environments, etc.

Nevertheless, over the recent years, in addition to the Central Election Commission, other institutions have issued sub-legal acts regulating the activities and conduct of public administration, the State Police, and the General Prosecutor's Office in relation to elections. In every case, their implementation has remained a challenge.

⁸ Electoral Code, Law on Political Parties, Law138/2015 on Decriminalization, etc.

GENERAL PROSECUTOR

Up until the 2019 election, the General Prosecutor's Office and the Central Election Commission have regularly signed memoranda of cooperation to establish additional bridges of collaboration beyond the constitutional and legal obligations of both parties during the electoral period.

In the 2021 election, the General Prosecutor, through General Instruction No. 2, dated March 31, 2021, which introduced amendments and additions to General Instruction No. 3, dated June 21, 2019, titled "On administrative and procedural measures to be taken by Prosecutor's Offices with general jurisdiction during the pre- and post-election period," in addition to reaffirming the approved measures, also regulated in a more specific and concrete manner the provision of information with data/indicators regarding criminal proceedings/cases, from the General Prosecutor's Office to the Central Election Commission.

In every instance, this arrangement ensured the preservation of investigative secrecy, the prohibition of publishing acts, and the protection of personal data in accordance with the law.

GOVERNMENT OF ALBANIA

On April 20, 2023, the Government of Albania approved Decision No. 234, dated 20.04.2023, "On taking measures and monitoring the activity, conduct or use of human, financial and logistical resources of the state administration, during the electoral process for the local elections for the year 2023".

According to CoMD 234/2023, the effort for the monitoring and for implementing specific rules of conduct for this remaining part of the campaign involves a large number of public administration employees. The role of the Task Force remains mainly within a structure, which is tasked to collect information, and denounce as appropriate possible violations of the electoral rules during the electoral period, to the prosecution body in the Prosecutor's Office, or to the State Police. Apart from the reporting and monitoring by Civil Society Organizations or international observers, there is no analysis of the effectiveness of this special structure.

CIVIL SERVICE COMMISSIONER

The Civil Service Commissioner has regularly approved, prior to the commencement of the electoral period, orders and guidelines aimed at the unification, monitoring and implementation of the law on civil servants in terms of the management of the recruitment process during the electoral period; the participation of civil servants in the institutions administering the electoral process; protection of their political rights and legal obligations; the interaction of civil servants with "media platforms" or "social networks", which are accessible to the public via the Internet, to avoid electoral propaganda, as well as concerning the measures that institutions should take to monitor the situation.

The Commissioner, upon analyzing the implementation of the legislation in force and of the by-laws approved by this Institution, is obliged to review the by-laws before the elections of May 11, 2025.

SUB-LEGAL ACTS OF THE CENTRAL ELECTORAL COMMISSION ON THE ORGANISATION OF THE 2025 ELECTIONS

The Central Election Commission (CEC) is the institution responsible for the organization and administration of elections. It directs and supervises the activity of the electoral administration, monitors the activity of electoral entities, state bodies and institutions and the media in relation to the elections, and resolves administrative requests or complaints related to the electoral process.

II. Sub-legal acts, by subject matter

By December 2024, about 5 months before the elections, 230 such acts have been approved, of which 14 acts determine rules for the organization of the upcoming parliamentary elections.

The monitoring of the CEC webpage⁹, shows that the regulator, pursuant to its competences, has adopted¹⁰ decisions to approve the rules for one of the most important electoral processes, which will be implemented for the first time in the history of pluralistic elections in Albania, concerning the procedure of out of country voting.

The normative acts adopted for this purpose have regulated, in addition to the manner and procedure of voting of Albanian citizens living and working abroad, also the features and specifications of the logistics, equipment, the electronic systems and platforms that can be used, the necessary documentation required to prove the residence of the Albanian voter voting

⁹ Referring to the Electoral Code, the CEC is obliged to publish approved acts on its official website.

¹⁰ as per the acts in the attached table.

outside the territory of the Republic of Albania and the rules for the registration of these voters and the preparation of the voter list.

Also, the Regulator has approved the delimitation and establishment of 93 (ninety-three) Electoral Administration Zones (EAZs) and the number of mandates for each electoral zone for the Assembly Elections of May 11, 2025. Municipalities with more than 80 thousand citizens with the right to vote are divided by the CEC into more than one EAZ, respecting the criterion of the indivisibility of the territory of the administrative unit, the continuity and compactness of the territory, geographical barriers, good communication opportunities within the territory and an approximate number of voters.

From the review of the acts approved by the Regulator, it results that the CEC has not issued normative acts, or has not reviewed the approved acts in relation to:

- Establishing rules for electoral entities;
- Financing of the electoral campaign;
- Monitoring of the media during the electoral campaign;
- Implementation of electronic systems for counting and electronic identification of voters;
- Organization and functioning of the second and third level electoral commissions, respectively CEAZ and VCC, which are the competence of the Regulator;
- Methodology of financial control of political parties in elections, rules for financial reporting of electoral entities, the role and responsibilities of funders of electoral entities, their independent monitoring and audit, obligations set out in Article 20, point 1, letter f, and Law No. 8580, dated 17.02.2000 "On Political Parties";
- Monitoring of the media, provided for by Article 20, point 1, letter ç.

Sub-legal acts as approved by the State Elections Commissioner

Until the time of drafting of this report (December 2024), the Commissioner has adopted in total 192 decisions, 4 of which are acts concerning the conduct of the 2025 election. The Commissioner's acts, referring to the powers defined in Article 19 of the Electoral Code, must regulate relations with the object (according to the acts in the attached table):

- Financial management (drafting the CEC budget for the organization of elections for the calendar year, determining the amount of funds from the state budget for political parties);
- Registration of electoral entities;
- Appointment of CEAZ commissioners;

- Approval of models and technical specifications of electoral materials;
- Verification of decriminalization forms;
- Review of complaints and denunciations regarding the use of state resources by electoral entities.

The commissioner has approved 4 decisions¹¹ in total, which regulate some important aspects of the electoral process (technical and procedural), mainly concerning the voting of Albanian citizens living abroad and the technical rules of administration.

The process of voting from the outside of the territory of the Republic of Albania seems to be the “Achilles heel” in the upcoming elections. The allocated timeframe of about 4 and a half months before the elections may be tight to guarantee the success of the right to vote of Albanian voters living abroad, however, the ongoing monitoring of this process will provide more accurate data.

In relation to Article 92/4 of the Electoral Code, the CEC, no later than six months before the election date, provides a sufficient number of persons to monitor the fulfillment of the obligations related to campaign financing and other obligations under this Code by electoral subjects.

Currently, on 06.12.2024, with a delay of about one month, the CEC has approved the number of monitors for the parliamentary elections of 11 May 2025. The process of their selection and appointment has not yet begun.

Attached is a table with the approved bylaws. (in Albanian version)

¹¹ as per the acts in the attached table.

Bashkëlidhur tabela me aktet nënligjore të miratuara (Dhjetor 2024)

NR.	KOHA	DISPOZITAT QË PERCAKTOJNE PERMBAJTJEN E AKTIT	VEPRIMI	MIRATUESI/VEPRUESI
1	Dhjetor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja "g" dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"	VENDIM PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË PAKICAVE KOMBËTARE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
2	Dhjetor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja "g" dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"	VENDIM PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
3	Dhjetor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja "g" dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"	VENDIM PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
4	Dhjetor 2024	Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 399, datë 5.12.2024 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin", nenit 19, pikat 1, shkronjat "ë" dhe "n" e 2, nenit 92/4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"	VENDIM PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
5	Dhjetor 2024	Neni 20, pika 1, shkronja "a", pika 2 shkronja "a" dhe pika 3, nenit 27 dhe nenit 28 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"	VENDIM PËR CAKTIMIN E KUFIJVE DHE NGRITJEN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025	Komisioni Rregullator
6	Dhjetor 2024	Neni 20, pikat 2 shkronja "b", e 3, nenit 74, pika 1, neni 75 dhe neni 76, të ligjit	VENDIM PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË MANDATEVE PËR ÇDO	Komisioni Rregullator

		nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	ZONË ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025	
7	Nëntor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja “b” e “gj”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	VENDIM PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK DHE OPERACIONAL PER TRAJNIMIN E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE DHE TË DISA AKTORËVE TË TJERË PËR PROCESET ZGJEDHORE	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
8	Nëntor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 24 dhe nenit 25, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,	VENDIM PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË VITIT 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
9	Nëntor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,	VENDIM PËR RREGULLAT TEKNIKE TË ADMINISTRIMIT, NËPËRMJET “PER”-it, TË KËRKESAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
10	Nëntor 2024	Neni 19, pikat 1, shkronja “b” e “gj”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	VENDIM PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR TRAJNIMIN DHE MONITORIMIN E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE DHE TË DISA AKTORËVE TË TJERË PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
11	Nëntor 2024	Nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 24, pika 5, nenit 25/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	VENDIM PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURËN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT	Rregullator
12	Nëntor 2024	Neni 20, pika 1, shkronjat “dh” “e” “ë”, nenit 25, pika 5 të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	VENDIM PËR MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE THEMELORE TE FUNKSIONALITETIT TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	Rregullator

13	Nëntor 2024	Neni 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	VENDIM PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEM PËR TË VËRTETUAR QËNDRIMIN E ZGJEDHËSIT SHQIPTAR QË VOTON JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME QËLLIM REGJISTRIMIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE JASHTË VENDIT	Rregullator
14	Tetor 2024	Neni 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pikat 1 dhe 12, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	VENDIM PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE	Rregullator